



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 891/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesues, Rustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga Bekim Kozhani, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.891/2021, i paraqitur nga Bekim Kozhani, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) Nr. 2948/2021, të datës 03.11.2021, me të cilin ka kërkuar rinumërim në këto Vendvotime: 1322E/03R, 1305E/02D, 1313/01D, 1312E01D, 1328/01R, 1318/02R.

A r s y e t i m

Me datë 04.11.2021, PZAP-i, ka pranuar apelin e Bekim Kozhani, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), dega në Lipjan, ka parashtruar këtë apel lidhur me pa rregullsitë e ndodhura gjatë procesit të numërimit dhe administrimit të rezultateve në vendvotime dhe procedimit të tyre. Më tutje në apel parashtruesi thekson se konsideron që është dëmtuar me vota, duke mos u pasqyruar si duhet në Formularët e Rezultateve për Kandidat-FRK në këto vendvotime: 1322E/03R, 1305E/02D, 1313/01D, 1312E01D, 1328/01R, 1318/02R.

Si provë në apel ka bashkangjitur tri kopje të deklaratave të votuesve.

Paneli, pasi që shqyrtoj apelin, si dhe shkresat e lëndës vlerësoi se:

Apeli është i pabazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin,

në rastin konkret, paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur mos përfshirje të votave të parashtresit të apelit gjatë numërimit të votave, për faktin se thëniet e tij nuk mbështeten në asnjë provë konkrete por janë të përgjithshme e jo të konkretizuara, sepse pritet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mos përfshirje të saktë votave në rezultat përfundimtar, si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Paneli i shqyrtoi deklaratat e bashkangjitura në apel nga ana e ankuesit, mirëpo gjeti se të njëjtat nuk janë bazë e mjaftueshme për të konkluduar se në këto vendvotime ka pasur parregullsi, rrjedhimisht pretendimi ankimor i parashtresit të apelit se apelin e mbështet në pohimet e dëshmitarëve nuk është provë e mjaftueshme, për më tepër, paneli rikujton se vota është e fshehur, dhe publikimi i saj shpërfaq vullnetin e çdo votuesi në fletëvotim që është në kundërshtim me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret si fakt provues pretendimi i tillë se një votues pohon faktin se ka votuar në ndonjërin nga vendvotimet që kandidati ka pretenduar në apel. Në rastin konkret apeluesi nuk ka paraqitur asnjë provë tjetër përveç deklaratave duke mos bashkangjitur asnjë Formularë të Rezultateve për Kandidat-FRK e cila do shërbente si provë, andaj në mungesë të provave paneli vendosi që apeli i paraqitur të refuzohet si i pa bazuar.

Si përfundim, Paneli vlerësoi se apeli i Bekim Kozhanit, kandidat për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Lipjanit, nga subjekti politik LDK, dega në Lipjan, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje gjatë numërimit të votave për kandidat, andaj kërkesa e apeluesit për të rinumëruar fletëvotimet në Vendvotimet e lartcekura, vlerësohet si i pa bazuar. Shkaqet për rinumërimin e këtyre fletëvotimeve në këto QV, sipas vlerësimit të panelit do duhej të jenë shumë serioze dhe bindëse, si dhe të rezultojnë nga provat e mjaftueshme, bindëse dhe të pa kontestueshme, te cilat në rastin konkret mungojnë.

Për arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr 891/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.